

V E N D I M
Nr. 728, datë 28.12.2000

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KOMISIONEVE TË REGJISTRIMIT TË
POPULLSISË DHE TË BANESAVE NË QARQE (PREFEKTURA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000, “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, me propozimin e zëvendësministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Ngritjen e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qarqe (prefektura).

1. Për organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të qarkut (prefekturës), krijohet komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave.

II. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Përbërja e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë), të jetë si vijon:

- Prefekti	kryetar
- Kryetari i këshillit të qarkut	nënkryetar
- Kontrollorë	anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të statistikës në qark	anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të bujqësisë në qark	anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të arsimit në qark	anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të shëndetësisë në qark	anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të buxhetit në qark	anëtarë
- Mbikëqyrësit e drejtorive të statistikës në qark	anëtarë
- Përgjegjësit e zyrave të gjendjes civile në qark	anëtarë
- Drejtori i drejtorisë së policisë në qark	anëtar

III. Detyrat e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Në zbatim të udhëzimeve dhe të përcaktimeve të Institutit të Statistikave komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në qark (prefekturë), ka këto detyra:

- organizon punën përgatitore për regjistrimin e popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të qarkut (prefekturës);
- përzgjedh personelin e regjistrimit;
- trajnon kontrollorët dhe merr masat e nevojshme për zbatimin, në kohë dhe me korrektësi, të procesit të regjistrimit;
- jep asistencë teknike për zyrat e regjistrimit në bashki dhe komuna, të cilat janë brenda territorit të prefekturës, dhe bën inspektime periodike në këto zyra, për zhvillimin e procesit të regjistrimit;
- raporton, një herë në javë, pranë Institutit të Statistikave për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit në qark (prefekturë) dhe çdo ditë gjatë muajit të regjistrimit;
- në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me zyrat e regjistrimit në bashki dhe komunë, organizon punën për marrjen dhe dërgimin e pyetësorëve të regjistrimit dhe të materialeve shoqëruese në komisionet dhe në zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komuna.

IV. Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Komisionet e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qarqe (prefektura) ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri më 31.1.2001.

V. Detyrimet metodologjike

1. Komisionet e regjistrimit në qarqe (prefektura), për ndjekjen dhe zbatimin e veprimeve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave, udhëzohen nga Instituti i Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta